




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



Vendim nr. 4

“Mbi korrigjimin e vendimi nr. 74 datë 02.11.2018”

Sot në datë 27.12.2018, trupi gjykues, ora 15:00 e përbërë nga:

| | |
|--------------------------|--------------------|
| Etleda Çiftja | (Kryesuese) |
| Roland Ilia | (Relator) |
| Brunilda Bekteshi | (Anëtare) |

Bazuar në nenin 112 të Kodit të Procedurave Administrative: “Korrigjimi i gabimeve materiale në aktin administrativ” sipas të cilit përcaktohet se:

1. *Organi publik, në çdo kohë, kryesisht apo me kërkesë, mund të korrigjojë gabimet e shkrimit, gabimet në përllogaritje dhe pasaktësi të tjera të dukshme, në një akt administrativ.*
2. *Organi publik ka të drejtë të kërkojë kthimin e aktit administrativ të shkruar që korrigjohet, si dhe të çdo kopje të njësuar të tij.*

U mbledh për t’u njohur me kërkesën e relatorit të çështjes z. Roland Ilia, për korrigjimin e një gabimi material në numrin e vendimit të subjektit të rivlerësimit Artor Yllit:

Në faqen 1, të vendimit nr. 74 datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri 74 të korrigjohet me numrin 73.

Trupa pasi konstatoi se kërkesa e relatores qëndron dhe pasaktësia është vendosur dukshëm si pasojë e një gabimi (lapsusi), në faqen e parë të vendimit.

V E N D O S I:

1. Në faqen 1, të vendimit nr. 74 datë 02.11.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, numri 74 të korrigjohet me numrin 73. Të njoftojë subjektin e rivlerësimit, Komisionerin Publik dhe Vëzhguesin Ndërkombëtar për këtë korrigjim.
2. Vendimi i korrigjuar të publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Trupi Gjykuese

Etleda Çiftja
Roland Ilia
Brunilda Bekteshi

(Kryesuese)
(Relator)
(Anëtare)



Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

kpk.al

Adresa: Rruga e Kavajës, ish - godina e “Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve”, Tiranë.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 145 Akti

Nr. 73 Vendimi

Tiranë, më 02.11.2018

V E N D I M

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me anë të trupit gjykues të përbërë nga:

Etleda Çiftja
Brunilda Bekteshi
Roland Ilia

Kryesuese
Anëtare
Relator

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prezencë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, më datë 31.10.2018, ora 10:00, në katin e dytë, pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, me adresë: Rruga Kavajës, Godina e ish-Lidhjes Shkrimtarëve dhe Artistëve, Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKT I RIVLERËSIMIT: **Z. Artor Ylli**, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit

BAZA LIGJORE : Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”;

Ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligjin nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoji relatorin e çështjes, komisionerin Roland Ilia, dëgjoji subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, vëzhguesin ndërkombëtar, pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, i cili në seancën dëgjimore publike kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURIALE

1. Z. Artor L. Ylli, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë. Subjekti i rivlerësimit është emëruar, më datë 03.06.2015, në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Neni 179/b, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar” parashikon se “Të gjithë këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësit ligjorë pranë gjykatave administrative, ndihmësit ligjorë pranë Prokurorisë të Përgjithshme do të rivlerësohen *ex officio*”.
3. Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 84/2016, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka qenë në pozicionin e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe brenda datës 31.01.2017, ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së, DSIK-së dhe KLD-së dokumentacionin e kërkuar në zbatim të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë është subjekt rivlerësimi *ex officio*.
4. Bazuar në nenin 14, pika 2, të ligjit nr. 84/2016 dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (këtu e më poshtë referuar si “Komisioni”), ka hedhur shortin, më datë 15 maj 2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 2, i përbërë nga komisionerët Alma Faskaj, Roland Ilia dhe Brunilda Bekteshi. Relator

i çështjes, u zgjodh me short, komisioneri Roland Ilia. Me vendimin, nr. 40, datë 16.07.2018, Komisioni, vendosi që komisionerja Alma Faskaj të zëvendësohet nga komisionere Etleda Çiftja.

5. Me vendimin nr. 1, datë 15.05.2018, trupa gjykues, vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Artor Ylli, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe rivlerësimin e aftësisë profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren znj. Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët kanë deklaruar mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

6. Me vendimin nr. 2, datë 22.10.2018, trupi gjykues, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, bazuar në rezultatet e hetimit paraprak, të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit se i ka kaluar barra e provës mbi rezultatet e hetimit, në përputhje me nenin 52 të ligjit nr. 84/2016; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurës Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji në lidhje me deklarin e konfliktit të interesit, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si edhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

7. Më datë 23.10.2018, me anë të postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës sipas nenit 52 të ligjit nr. nr. 84/2016 dhe që të sjellë prova për të provuar të kundërtën, nëse disponon, brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative, duke paraqitur kërkesë për njohje me dosjen brenda një dite nga marrja e njoftimit me *e-mail*; (iv) përbërjen e trupit gjykues.

8. Më datën 29.10.2018, subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, njoftoi në rrugë elektronike dhe vuri në dispozicion të Komisionit, parashtrësë me pretendimet e tij, si dhe shpjegime përfundimtare, të cilat u administruan nga ana e trupit gjykues.

9. Më datë 29.10.2018, me anë të vendimit nr. 03, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, në seancë dëgjimore në përputhje me nenin 55 të ligjit nr. 84/2016 dhe, me anë të postës elektronike, subjekti i rivlerësimit u njoftua se seanca dëgjimore do të zhvillohej më datë 31.10.2018, ora 10:00 paradite, pranë Komisionit, në Godinën e ish-Lidhjes së Shkrimtarëve dhe Artistëve, Tiranë.

II. SEANCA DËGJIMORE

Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, Z. Theo Jacobs. Gjatë

seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, shprehu qëndrimin e tij, duke parashtruar se i qëndronte shpjegimeve përkatëse të dërguara pranë Komisionit, lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij.

Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli. Trupi gjykues ndërpreu seancën dëgjimore të datës 31.10.2018, për të rifilluar më datë 02.11.2018 për shpalljen e vendimit.

III. BASHKËPUNIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT, SIPAS NENIT 48 TË LIGJIT NR. 84/2016

Gjatë të gjitha fazave të hetimit, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48 të ligjit nr. 84/2016.

IV. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI LIDHUR ME VLERËSIMIN E PASURISË

Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI.

10. Në përputhje me nenin 33, pika 5, të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja, ka dërguar një raport të hollësishëm¹ dhe të arsyetuar, nr. *** prot., datë 05.02.2018, për subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, pasi ka përfunduar procedurat e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së tij dhe personave të lidhur, si dhe ka vënë në dispozicion të Komisionit dosjen me dokumentet e administruara prej tij.

11. Nga aktet pranë ILDKPI-së, rezulton se, z. Artor Ylli, është bërë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së, bazuar në nenin 31, të ligjit nr. 84/2016 dhe se, për nga funksioni që ka pasur nuk ka qenë përfshirë në kategorinë e subjekteve që mbartnin detyrim për deklarimin pasurisë pranë ILDKPKI-së. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

¹Shih, shkresën nr. *** prot., datë 28.02.2018, te dosja e ILDKPKI-sw.

Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni.

12. Komisioni, si organ i legjitimuar nga Kushtetuta dhe ligji nr. 84/2016 për të bërë rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, ka hetuar në mënyrë të pavarur, çdo informacion dhe konkluzion të institucionit të sipërpërmendur, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016.

13. **Hetimi administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në:** (i) verifikimin e vertetesise se deklarimeve ne lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) në verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) në evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose përdorim; dhe (iv) në evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, me qëllim evidentimin e faktit nese subjekti rivlerësimit arrin të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij dhe personave të lidhur me të, si dhe nëse gjendet në kushtet e deklarimit të pamjaftueshëm të pasurisë, në kuptim kjo të nenit D, pika 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3, të ligjit nr. 84/2016.

V. Hetimi administrativ kryer nga Komisioni

Mbi asetet e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën e pasurisë në zbatim të ligjit nr. 84/2016.

Referuar deklaratës së rivlerësimit kalimtar² të dorëzuar nga subjekti, më datë 29.01.2017, pranë ILDKPKI-së, e cila mban nr. *** indeksi, rezulton se subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, ka deklaruar si më poshtë:

1. Llogari bankare në “Internacional Comercial Bank³”, me gjendje 0 (zero) lekë, më datë 29.01.2017.

Në deklaratën “Vetting”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar një llogari bankare në “Internacional Comercial Bank⁴”, me gjendje 0 (zero) lekë, më datë 29.01.2017.

1.1 Nga hetimi administrativ i Komisioni u konstatua se, subjekti i rivlerësimit rezultonte të kishte pasur llogari rrjedhëse në monedhën dollar, pranë “**International Commercial Bank**”, në periudhën 2010 - 2013, sipas shkresës nr. *** prot., datë 03.07.2018.

²Deklarata “Vetting”, sipas shtojcës 2.

³Ju i keni bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie në USD, datë 20.10.2016, të International Commercial Bank, me gjendje 0.00 USD (aneks nr. 4/2).

⁴ Ju i keni bashkëlidhur deklaratës: nxjerrje llogarie në USD, datës 20.10.2016, të International Commercial Bank, me gjendje 0.00 USD (aneks nr. 4/2).

1.2 Nga historiku i kësaj llogarie u konstatua se ishin kryer dy transfertat, (1) në datën 14.12.2010, në vlerën 16,000 USD, me përfitues shtetasin kinez, z. Zh. dhe (2) në datën 13.02.2012, në vlerën prej 30,000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi. Gjithashtu, rezultonte të ishte kryer dhe një transfertë *cash*, në vlerën 10,000 USD, më datë 02.11.2010, me përfitues shtetasin kinez, z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi.

1.3 Llogaria ne kete banke rezultonte me balancë dhe se kjo llogari mbante status “jo aktiv”.

1.4 Lidhur me transfertat e kryera nga subjekti pranë “ICB”-së, gjatë hetimit ai shpjegoi se për kryerjen e këtyre transfertave kishte vepruar për llogari të shtetasit N.M. me cilësinë e përfaqësuesit të autorizuar të tij. Sipas subjektit ai kishte kryer stazhin e asistent avokatit pranë zotit N.M.

1.5 Më tej, subjekti deklaroi se në kryerjen e këtyre transfertave kishte vepruar në përputhje me kërkesat e parashikuara në ligjin nr. 8269, datë 23.12.1997, “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në aktet nënligjore të dala në zbatim të tij, në rregulloren “Për veprimtarinë valutore”, miratuar me vendimin, nr. 70, datë 30.09.2009, të Këshillit Mbikëqyrës së Bankës së Shqipërisë...”.

1.6 Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti depozitoi dokumentacioni si më poshtë:

- i. Deklaratë të nënshkruar nga ana e tij;
- ii. Vërtetim i lëshuar nga avokati N.M.;
- iii. Deklaratë e z. N.M.;
- iv. Nxjerrje llogarie nga “International Commercial Bank”;
- v. Vërtetim për dorëzimin e deklaratës së pasurisë pranë ILDKPKI-së, datë 29.01.2017;
- vi. Inventari i dokumentacionit të dorëzuar pra në ILDKPKI-së, datë 29.01.2017.

1.7 Nga verifikimi dhe analizimi i vërtetimit të lëshuar nga avokati N.M. të depozituar nga ana e subjektit, Komisioni, konstatoi se ky vërtetim konfirmonte se ai kishte filluar si asistent pranë zyrës së avokatisë së tij, më datë 01.09.2008.

1.8 Z. N.M., më datë 06.07.2018, ka lëshuar një deklaratë ku ka deklaruar se, më datë 14.12.2010 dhe më datë 13.02.2012, nga ana e tij u pranua fakti i transferimit të shumave prej 16,050 USD dhe 30,080 USD në “International Commercial Bank”, në drejtim të Republikës Popullore të Kinës për shtetasin Zh., sipas rregullave bankare deri në fund të vitit 2014.

1.9 Me shkresën nr. *** prot., datë 15.08.2015, z. N.M., ka shpjeguar se: “*Ka një biznes familjar dhe se, është marrë me aktivitet tregtar që nga viti 1993 e në vazhdim duke tregtuar artikuj të ndryshëm në tregun e lirë “***”, pranë ***, Tiranë.*”

1.10 *Prej vitit 1998 me biznesin e tij ka importuar mallra të ndryshme nga Republika Popullore e Kinës dhe se biznesin e kanë formalizuar/regjistruar në vitin 2002. Lidhur me pyetjen e parë sqaron se, deri në janar të vitit 2015, çdo shtetas shqiptar (si individ - jo biznes) kishte të drejtë të transferonte jo më shumë se 3,5 milion lekë ose vlerën e barabartë me të, për çdo vit kalendarik. Në vijim ai shpjegon se, detyrimet që kishte për blerje malli në Kinë ishin më shumë se 3.5 milion lekë, prandaj duke pasur marrëdhënie të mira shoqërore me z. Artor Ylli thotë se, transfertat prej 16,050 USD në një rast dhe 30,080 USD në një rast tjetër, janë kryer për llogarinë e tij por nga/dhe në emër të subjektit të rivlerësimit. Lidhur me arsyet e kryerjes së këtyre transfertave ka*

konfirmuar se, jo vetëm në vitet 2010 dhe 2012, por dhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumë e lejuar prej 3,5 milion lekësh. Duke qenë se, detyrimet që kishte në Kinë, nga blerja e mallrave, ishin më të mëdha se 3,5 milion lekë, transaksionet për diferencën e shumave të detyrimeve thotë se janë kryer nga z. Artor Ylli. Si arsye të kryerjes së këtyre transfertave konfirmon se, janë detyrimet që ka pasur në Kinë nga blerja e mallrave për tregti. Lidhur me origjinën e këtyre parave ai ka shpjeguar se, janë nga të ardhurat nga biznesi familjar në tregun e lirë “***”, tregti që deklaroi se e ka filluar prej vitit 1993 dhe e vazhdon edhe sot, si edhe të ardhurat nga aktivitetet e tjera tregtare.”

1.11 Per vertetësinë e deklarimeve si dhe burimin e ligjshëm të këtyre të ardhurave Komisioni hetoi, duke verifikuar në faqen e Web-it të QKB-së, nga ku i rezultoi se, shtetasi N.M., ishte aksioner me 40 % të kuotave të kapitalit në subjektin “***” sh.p.k., me NIPT ***.

1.12 Me qëllim identifikimin nëse shtetasi N.M. kishte kryer importe me Republikën Popullore të Kinës për vitet 2010 dhe 2012, Komisioni, kërkoi informacion nga Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.

1.13 Me shkresën nr. *** prot., datë 20.09.2018, **Drejtoria e Përgjithshme e Doganave** ka dërguar importet me origjinë nga Kina nga të cilat nuk u bë i mundur verifikimi i transfertës me shtetasin kinez Zh.

1.14 Pas analizimit të dokumentacionit të ardhur nga institucionet përkatëse në raport me shpjegimet e dhëna nga shtetasi N.M., me qëllim qartësimin mbi marrëdhënien ligjore e faktike të transfertave bankare të kryera nëpërmjet “ICB”, Komisioni, i kërkoi dëshmi këtij shtetasi duke i kërkuar të paraqitej personalisht pranë Komisionit.

1.15 Më datë 01.10.2018, shtetasi N.M., ndër të tjera deklaroi se: “Kishte njohur subjektin e rivlerësimit që në vitet 2008 - 2009, pasi e kishte pasur student të shkolla jo-publike “***” dhe më pas subjekti kishte qene asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse i duhej vërtetim si asistent avokat. Ai shpjegon se, transferta e bëra nga subjekti i rivlerësimit i kishin shërbyer aktivitetit të tij tregtar, por jo aktivitetit të shoqërisë “***” sh.p.k., ku ai është aksioner, por aktivitetit të subjektit “***” person fizik, i cili ka qenë i regjistruar në emër të bashkëshortes së tij. Gjithashtu, z. N.M., deklaroi se këto zhdoganime janë kryer nëpërmjet subjekteve të tjerë tregtare, për shkak se subjekti i bashkëshortes së tij, znj. M.M., kishte vështirësi në procedurat për zhdoganim. Në vijim të deklaramit z. N.M. konfirmon se, ka qenë prezent në momentin që z. Artor Ylli kishte kryer këto transferta, pasi paratë ju a ka dhënë ai vetë dhe se ato janë transferuar për llogari të tij në Kinë, për të shlyer detyrimet që kishte nga blerja e mallrave. Z. N.M. në përfundim të deklaramit ka sqaruar se, këto transferta janë kryer pa kundërshtim nga ana juaj, për shkak të lidhjeve miqësore dhe për shkak të besimit që kishte. Thekson sërish faktin se, paratë ishin të tijat, se subjekti i rivlerësimit i kishte dërguar për llogari të tij dhe se kjo gje ishte bere per shkak te lehtësirave që do sillte në zhdoganimin e mallrave”.

1.16 Mbi deklaramet e dhëna nga shtetasi N.M. se transfertat e bëra nga subjekti i rivlerësimit i kishin shërbyer aktivitetit të shtetases “***”, person fizik, Komisioni, verifikoi faqen e Web-it të QKB-së, në emër të kësaj shtetase, dhe i rezultoi se, kjo shtetase ishte regjistruar pranë QKB si person fizik, më datë 13.02.2002 , me NIPT ***, dhe aktivitet “tregtim me pakicë i mallrave të ndryshme ushqimore e industriale”, me dy adresa të deklaruara të ushtrimit të aktivitetit në

Tiranë, njëra e ndodhur në Rr. “****”, brenda ambienteve të tregut “****” dhe tjetra në Rr. “****”. Ky subjekt aktualisht është me statusin “çrregjistruar”.

1.17 Subjekti i rivlerësimit për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit shpjegoi se:

1.18 Mbi transfertat e kryera nga ana e tij jashtë vendit, i përmbahej deklarimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se deklarimi i shtetasit N.M., se e kishte njohur kur kishte qenë student pranë shkollës së lartë universitare “****”, ishte i pasaktë, pasi nuk kishte qenë student në këtë institucion.

1.19 Subjekti shpjegoi se e kishte njohur, z. N.M, gjatë vitit akademik 2007-2008, në Fakultetin e Drejtësisë, Universiteti i Tiranës, pasi ishte i angazhuar në këtë fakultet si pedagog i jashtëm për dhënien e lëndës “E Drejta Penale”. Në periudhën në të cilën ishte kryer kjo transfertë, nuk ka pasur asnjë bazë ligjore për të ndaluar një veprim të tillë. Nuk mund të penalizohej për një shkelje etike të një dispozite ligjore/etike që nuk ekziston.

1.20 Duke ripërsëritur faktin se ky veprim është kryer jashtë periudhës së rivlerësimit, dhe se avokati z. N.M ishte shembull për mua si avokat praktikant dhe e vështroja atë si bashkëpunëtor, në mënyrë që, në mes tyre, të kishte mirëbesim dhe raport të ndërsjellë. Z. N.M e kishte përgatitur, për të ushtruar profesionin në mënyrë të pavarur, dhe se gjatë përfaqësimit, kishte shmangur çfarëdo cenimi të pavarësisë dhe kishte respektuar etikën/rregullat profesionale të profesionit.

1.21 Gjithashtu, subjekti ka shpjeguar se i takonte bankës “ICB” -së të kontrollonte/vlerësonte ligjshmërinë dhe rregullshmërinë e kryerjes së këtij veprimi bankar, dhe në atë kohë operatorja e bankës “ICB”, i kishte deklaruar se ky veprim ishte i rregullt, dhe për këtë arsye, nuk mundet që ti atribuohet ky fakt si shkelje etike. Banka “ICB”, i kishte deklaruar aktualisht se ky veprim ishte i rregullt, por sot nuk mundet të kryhet një transfertë e tillë, pasi kanë ndryshuar rregullat bankare dhe duhet të kesh llogari si biznes për të kryer një veprim të tillë.

1.22 Ishte i vetëdijshëm në një pasaktësi të dukshme në plotësimin e formularit të deklarimit të pasurisë “Vetting”, për shkak se nuk është deklaruar saktë llogaria bankare në bankën “ICB” (llogaria ka qenë në USD dhe jo në Lek), dhe kjo pasaktësi ka ndodhur për shkak të pakujdesisë dhe ngarkesës në momentin e mbledhjes së të dhënave për plotësimin e deklarimit “Vetting”, si dhe faktit se kjo llogari nuk është përdorur kurrë për interesat e mia dhe faktit se ishte herë e parë që ishte bërë subjekt deklarimi, dhe se s’kishte pasur ndonjë lloj motivi dhe qëllimi për këtë pasaktësi, duke reflektuar një qëndrim kritik ndaj vetes për këtë pakujdesi.

1.23 Sipas nenit 27 të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003, ishte detyrë e institucionit të ILDKPKI-së, që ta thërriste për sqarime të hollësishme dhe argumentet përkatëse lidhur me mosdeklarim e saktë të llogarisë bankare në bankën “ICB”.

1.24 Komisioni, pasi shqyrtoi dhe analizoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe konstatimet e dala nga hetimi arrin në konkluzionin se:

1.25 Referuar nenit D, pika 3, të Aneksit të Kushtetutës “*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të lidhshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*”.

1.26 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumata që ai ka transferuara në për llogari të shtetasit kinez Zh. kanë burim tregtinë e mallrave ose që detyrimi dhe borxhi ndaj

shtetasit kinez Zh. ishte për blerje mallrash, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë kontratë apo dokument tjetër që ta vërtetonte këtë.

1.27 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga ai vetë apo z. N.M., që janë përdorur për krijimin e shumave të transferuara si më poshtë:

- më datë 14.12.2010, në vlerën 16,000 USD, me përfitues z. Zh.;
- më datë 13.02.2012, në vlerën prej 30,000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe
- më datë 02.11.2010, transfertë *cash* në vlerën 10,000 USD, me përfitues shtetasin kinez, z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi

1.28 Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues lidhjen dhe shkakun se përse ai duhet ta kryente këtë transfertë në favor të z. N.M. apo biznesit të tij familjar duke mos provuar se:

- i. Ai ka qenë asistent pranë avokat z. N.M., më datë 01.09.2008, pranë zyrës së tij avokatore, pasi nuk paraqiti as dokumente që provonin se z. N.M. kishte qenë avokat dhe as vërtetim nga Dhoma e Avokatisë Tiranë se ai ishte regjistruar në regjistrin e asistentëve avokatë pranë Av. N.M., sipas ligjit “Për Avokatinë”;
- ii. Ku janë njohur subjekti i rivlerësimit me z. N.M.

1.29 Në lidhje me vendin e njohjes, ka mospërputhje midis deklarimeve të subjekti të rivlerësimit dhe deklarimeve të dhëna nga shtetasi N.M.. Në dëshminë e tij dhënë Komisionit, datë 01.10.2018, z. N.M. thotë se: “*Ju ka njohur që në vitet 2008 - 2009, pasi ju ka pasur student të shkolla jo-publike “***” dhe më pas keni qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse ju duhej vërtetim si asistent avokat.*”, ndërsa nga deklarimi në formularin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë Tiranë.

1.30 Deklarimet e bëra nga, z. N.M., nuk u provuan me dokumentacion ligjor provues, me qëllim që të mbështesnin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkakun e kryerjes së këtyre transfertave si dhe mundësitë financiare nga burime të ligjshme të këtyre shumave.

1.31 Subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti asnjë dokument shoqërues që të vërtetonte burimin e transfertave. Për transfertat tregtare me mallra, subjektet e licencuara kërkojnë nga klientët e tyre, paraqitjen e dokumentacionit të mëposhtëm:

a) kërkesa për kryerjen e veprimit e nënshkruar nga vetë kërkuesi ku pasqyrohet natyra e veprimit dhe qëllimi për të cilin kryhet ky veprim. Në këtë kërkesë, subjekti deklaroi se dokumentacioni i paraqitur nuk është përdorur më parë për të justifikuar kryerjen e transfertave të tjera për të njëjtin mall dhe vlerë;

b) fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe fatura pro-forma dhe/ose kontrata ku përcaktohet dhe forma e pagesës.

1.32 Subjekti i rivlerësimit pranon se e ka kryer këto transfertat në vitet 2010 - 2012 dhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumën e lejuar prej 3,5 milion lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor.

2. Detyrimet tatimore ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në shumën prej 242,518 lekë.

2.1 Në deklaratë “Vetting” të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka detyrime fiskale të pashlyera ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në shumën 242,618 lekë.

2.2 Mbi këto detyrime, institucioni i ILDKPKI-së, ka konkluduar se nga verifikimi i shkresave të dërguara nga DRT-ja Tiranë⁵ dhe QKB-ja⁶, subjekti i rivlerësimit është regjistruar me NIPT ***, nuk ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti i avokatisë por vetëm detyrime sipas shkresës së ardhur nga DRT-ja Tiranë, rezultonte me detyrime të papaguara në vlerën prej 47,618 lekësh. Ndërsa referuar përgjigjes së ardhur nga QKB, subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, person fizik me NIPT ***, figuron me status “pezulluar” që nga data 06.10.2016.

2.3 Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, u konstatua se subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli është regjistruar pranë QKB-së, si person fizik, me NIPT ***, dhe se aktualisht në regjistrin tregtar ky subjekt rezulton me status “Çregjistruar”. Ky subjekt ishte regjistruar pranë QKB-së, më datë 14.10.2010, dhe se kishte pasur si adresë të deklaruar: Banesë private nr. ***, autostrada Tiranë - Durrës, km ***, ***, Tiranë, dhe si objekt të veprimtarisë në fushën e avokatisë, konfirmuar me shkresën nr. *** prot., datë 11.07.2018, të QKB-së.

2.4 DRT-ja Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.07.2018, ka konfirmuar se, nga të dhënat e sistemit tatimor C@ts rezulton se, z. Artor L. Ylli, me ***, rezultonte i regjistruar si person fizik, me NIPT ***, me aktivitetet “aktivitete juridike”, i regjistruar në organin tatimor, më datë 14.10.2010. Të ardhurat e realizuara sipas deklaratave vjetore të dorëzuara nga ana e këtij subjekti, për vitet 2010 - 2014 janë 0 (zero). Nuk ka deklaruar qarkullim dhe as fitim.

2.5 Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë, konstatohet se më datë 06.07.2018, subjekti i rivlerësimit ka detyrime ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në vlerën totale prej 193,061 lekësh, si dhe rezultonte i regjistruar si individ privat për përgjegjësinë tatimore, tatim mbi të ardhurat individuale (DIVA), por se nga ana tij nuk ishte dorëzuar deklarata individuale e të ardhurave.

2.6 Mbi këto konstatime të detyrimeve tatimore, Komisioni i kërkoi deklarime subjekti të rivlerësimit i cili ndër të tjera deklaroi se: *“Detyrimet tatimore të papaguara i përkasin periudhave para dhjetorit 2014 dhe se kanë lindur si rezultat i ushtrimit të aktivitetit si avokat. Në muajin nëntor 2017, kishte kryer disa pagesa në favor të Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, nëpërmjet “Alpha Bank” dhe se ishte njoftuar nga administrata tatimore se ishin për fshirë disa detyrime tatimore sipas kushteve të përcaktuara në ligjin nr. 33, datë 30.03.2017, “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si edhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit”.*

2.7 Pas analizimit të dokumentacionit dhe vlerësimit të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni, konstatoi se, subjekti i rivlerësimit ishte i regjistruar si individ privat për përgjegjësinë tatimore “Tatim mbi të Ardhurat Individuale”, ndërkohë që referuar pikës 4 të nenit 13 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.2008, “Për Tatimin mbi të Ardhurat”, i ndryshuar, përjashtohen

⁵ Aneks nr. 31, në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶ Aneks nr. 30, në dosjen e ILDKPKI-së.

nga detyrimi për plotësimin dhe dorëzimin e deklaratës individuale vjetore të të ardhurave të gjithë individët që realizojnë të ardhura bruto vjetore nga të gjitha burimet në shumën e përgjithshme më pak se 2,000,000 (dy milionë) lekë.

2.8 Më tej, Komisioni konstatoi se shumica e detyrimeve deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”, nuk përputheshin me detyrimet tatimore që konfirmoheshin nga Drejtoria Rajonale Tatimore, si dhe subjekti i rivlerësimit nuk kishte deklaruar as qarkullim dhe as fitim nga aktiviteti tregtar i avokatisë.

2.9 Gjithashtu, Komisionit i rezultuan mospërputhje edhe të shumave të detyrimeve ndaj Njesisë Administrative Kashar, të deklaruar nga vetë subjekti, **në vlerën prej 143,780 lekësh, me atë të konfirmuar nga kjo njësi**, në vlerën prej 144,100 lekësh.

2.10 Në vlerësim të fakteve dhe rrethanave të sipërcituara, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektit të rivlerësimit për sa më poshtë konstatoi:

- i. Mospërputhje mes deklarimit të subjektit se këto detyrime kishin ardhur si pasojë e aktivitetit të avokatisë, ndërkohë që sipas dokumentacionit të administruar në dosje rezultonte se nga ana e tij nuk kishte deklaruar as qarkullim e as fitim nga ky aktivitet;
- ii. Mospagimi i taksave dhe tatimeve, mund të duken si sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elementë të cilët cenojnë figurën e magjistratit.

2.11 **Subjektit të rivlerësimit në lidhje me faktet e konstatuara nga Komisioni, dërgoi shpjegimet dhe provat e tij si pjesë e pretendimeve përfundimtare dhe në seancë dëgjimore, ku shpjegoi se:**

2.12 Detyrimet tatimore të papaguara, i përkisnin periudhave tatimore dhjetor 2014 dhe më parë dhe që rezultonin të regjistruara në llogarinë e subjektit, deri në fund të vitit 2017 dhe kanë lindur gjatë kohës që ai ka ushtruar profesionin e avokatit.

2.13 Lidhur me këto detyrime tatimore, në muajin nëntor 2017, subjekti shpjegoi se kishte bërë disa pagesa të këtyre detyrimeve tatimore në “Alpha Bank” për Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Në zbatim të ligjit nr. 33, datë 30.03.2017, “Për pagesën dhe fshirjen e pjesshme të detyrimeve tatimore, doganore, si dhe procedura e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit, pas fshirjes së detyrimeve tatimore “Ju njoftojmë se efekti i tij është përfshirë në situatën tuaj financiare në sistemin informatik”.

2.14 Në nenin 45, të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, parashikohet se: *“Qendra Kombëtare e Biznesit ose gjykata nuk mund të kryejë çregjistrimin, në qoftë se brenda afatit 30-ditor, të përmendur në pikën 4, të këtij neni, administrate tatimore e kundërshton me shkrim çregjistrimin”.*

2.15 Kundërshtimi i çregjistrimit të tatimpaguesit nga administrata tatimore tregon shumën e detyrimeve tatimore të papaguara të tatimpaguesit dhe, në rastin e personit juridik, faktin se ai nuk ka paraqitur pasqyrat financiare të mbylljes së aktivitetit deri në momentin e likuidimit, ose nuk ka dorëzuar deklaratat tatimore.

2.16 Më tej, subjekti i rivlerësimit shpjegon se në lidhje me detyrimet tatimore të papaguara ndaj DRT-së Tiranë dhe Njesisë Administrative Kashar, kishte marrë dijeni se kishte detyrime si dhe pas interesimit në QKB, është informuar se është i çregjistruar pasi nga ana e DRT-së Tiranë dhe Njesisë Administrative Kashar, na ka ardhur shkresa me detyrime 0.

2.17 Ai shpjegon gjithashtu se nuk mund të mbante përgjegjësi për shkak të gabimeve të veprimeve të organeve shtetërore, të cilat nuk i kanë ushtruar detyrat e tyre si duhet (*DRT-ja Tiranë dhe Njësia Administrative Kashar*), dhe që kanë sjellë si pasojë që unë të keqinformohem lidhur me mospasjen e detyrimeve tatimore, pasi nëse ai do të vazhdonte të kishte detyrime tatimore, nga ana e QKB-së, nuk do të procedohej me çregjistrimin e tij.

2.18 Në vitin 2010 ishte regjistruar për herë të parë si person fizik (Avokat), në ish-Komunën Kashar, në kategorinë e biznesit të vogël, me qarkullim vlerën 40.000 lekë. Sipas legjislacionit të kohës, bizneset e kësaj kategorie nuk bënin bilanc, sepse detyrimet tatimore që paguante kjo kategori biznesi ishin fikse dhe nuk vareshin nga fitimi neto, madje as nga qarkullimi brenda kësaj fashë. Kjo kategori - thotë ai - i nënshtrohej vetëm pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël mbi qarkullimin, e cila për fashën 0 - 2.000.000 lekë ishte fikse. Gjatë kohës që kishte punuar avokat kishin lindur edhe detyrimet tatimore të cilat nuk kam pasur mundësi financiare për t'i paguar, për shkak se kam qenë një avokat i ri, të cilat janë deklaruar rregullisht në formularin e deklarimit të pasurisë "Vetting".

2.19 **Ai gjithashtu shpjegon dhe provon se, më datë 26.10.2018, (11.25 a.m), në Bankën Kombëtare Tregtare,** kishte shlyer totalin e detyrimit tatimor në favor të Njesisë Administrative Kashar, në shumën 144.100.0 lekë, si dhe pagesën për kamatëvonesën, në shumën 28.739.02 lekë. Ndërsa lidhur me detyrimin ndaj DRT-së Tiranë, subjekti shpjegoi se ky detyrim nuk është shlyer ende në favor të DRT-së Tiranë, por edhe ky detyrim do të shlyhej, pasi nuk kam mundësi financiare në këto momente për ta shlyer. **Ligji tatimor shqiptar,** nuk e pengon tatimpaguesin të shlyejë detyrimet tatimore edhe me vonesë dhe për këtë ai është i detyruar të paguajë për çdo ditë mbi afatin ligjor kamatëvonesë përkatëse, që llogaritet nga organi tatimor. Duke mbajtur parasysh se dispozitat e legjislacionit financiar nuk pengojnë pagimin e detyrimeve tatimore, përtej afatit të parashikuar. Nëpërmjet pagimit të detyrimeve nga ana e tij, /do të ishte përmbushur/përmbushet detyrimi ndaj shtetit, e për rrjedhojë nuk mund të konkludohet për shkelje etike nga na e tij.

2.20 Subjekti i rivlerësimit në seancën dëgjimore depozitoi mandatpagesat e detyrimeve të taksave dhe detyrimeve tatimore ndaj Njesisë Administrative Kashar, në shumën prej 144,400 lekësh.

2.21 **Komisioni, duke pasur parasysh faktet e dala nga hetimi i thelluar, shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit, si dhe ligjin e zbatueshëm, arrin në përfundimin se:**

2.22 Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar detyrimin tatimor ndaj Njesisë Administrative Kashar, në deklaratën "Vetting" të vitit 2017, seksioni detyrime.

2.23 Pavarësisht faktit të ai i ka paguar detyrimet në momentin kur ju paraqitën rezultatet e hetimit, ai duhej të kishte pasur dijeni dhe të kishte paguar atë para deklaratës "Vetting" të vitit 2017. Pra deklarimi i detyrimit dhe/ose shlyerja e tij duhet të kishin ndodhur para se të deklaronte.

2.24 Pretendimi i subjekti se nuk kishte dijeni për këtë detyrim në ngarkim të tij, nuk qëndron pasi subjekti nuk provoi pamundësinë e mos pasjes dijenisë së tij në lidhje me këtë detyrim.

2.25 Mospagimi i taksave e tatimeve, pranohet nga vetë subjekti i rivlerësimit, dhe sikurse rezultoi e provuar këto detyrime u paguan gjatë procesit të rivlerësimit.

2.26 Trupi gjykues, çmon se është e vërtetë që legjislacioni tatimor, parashikon se në rast pagesë më vonesë aplikohen penalitete, por çmon se këto detyrime u paguan gjatë procesit dhe veprimet apo mosveprimet e tij janë sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elementë të cilët cenojnë figurën e magjistratit.

VI. KONTROLLI I FIGURËS

Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (tëfetuuar si “**DSIK**”), ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të pa përshatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

- i. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, **DSIK-ja ka konstatuar përshatshmërinë për vazhdimin e detyrës të subjektit të rivlerësimit, z. Artor L. Ylli.**

VII. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

Në mbështetje të pikës 2, të nenit 42, të ligji nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ndihmësit ligjor pranë Gjykatave Administrative vlerësohen bazuar në:

- a) *relacionet dhe mendimet ligjore të përgatitura; dhe*
- b) *rezultatet e testimit pranë Shkollës së Magjistraturës.*

Lidhur me kriterin e parë vlerësues, është përgatitur një Raport i hollësishëm nga Inspektorati i Këshillit të Lartë të Drejtësisë si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit bazuar në ligjin nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Raporti i hartuar nga Inspektorati i KLD-së

Ky raport ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të mëposhtme të vlerësimit:

- a) Aftësitë profesionale;
- b) Aftësitë organizative;
- c) Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; dhe
- d) Aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

Ky raport është hartuar bazuar në përshkrimin dhe analizimin e:

- 1) Formularit të vetëdeklarimit, të 3 dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga vetë subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga vetë subjekti i rivlerësimit;

- 2) 5 dosje gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor;
- 3) Të dhënat nga burimet arkivore të KLD-së, të cilat në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, mungojnë për shkak se detyra e tij nuk ka qenë në juridiksionin e KLD-së.

Rezultatet e testimit pranë shkollës së Magjistraturës

Shkolla e Magjistraturës me shkresën nr. *** prot., datë 23.05.2018, ka dërguar rezultatet e testimit të aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, të parashikuar në nenin 179/b, pika 4, të Kushtetutës dhe sipas parashikimeve të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Rezultoni se, me vendimin e Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës, nr. 17, datë 21.05.2018, janë miratuar rezultatet e të dy fazave të testimit, për vlerësimin e aftësive profesionale për subjektet e rivlerësimit *ex officio*, zhvilluar nga kjo shkollë në datat 7 - 8 maj të vitit 2018.

Nga verifikimi i tabelave të rezultateve konstatohet se në fazën e parë të testimit të aftësive profesionale subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, ka marrë 64 pikë nga 100 pikë të mundshme, ndërsa në fazën e dytë ka marrë 134 pikë nga 200 të mundshme.

Ndërsa me shkresën nr. *** prot., datë 27.09.2018, Shkolla e Magjistraturës na konfirmon se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, **subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjek programin dyvjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.**

Në përfundim, lidhur me kriterin profesional, trupi gjykues pas propozimit të relatorit të çështjes arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka arritur nivel minimal kualifikues, në kuptim të nenit 59 germa c) të ligjit nr. 84/2016.

VIII. VLERËSIMI TËRËSOR

Trupi gjykues, në vlerësimin tërësor në kuptim të nenit 4, pika 2, të ligjit nr. 84/2016, dhe pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, për të tri kriteret e vlerësimit, arrin në përfundimin se:

Në lidhje me vlerësimin e pasurisë

1. Për transfertat e kryera nga banka “ICB”

- i. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumatat që ai ka transferuara për llogari të shtetasit kinez, z. Zh., kanë burim tregtinë e mallrave ose që detyrimi dhe borxhi

ndaj shtetasit Zh. ishte për blerje mallrash, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë kontratë apo dokument tjetër që ta vërtetonte këtë.

- ii. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga ai vetë apo, z. N.M., që janë përdorur për krijimin e shumave të transferuara si më poshtë:
 - ✓ më datë 14.12.2010, në vlerën 16,000 USD, me përfitues shtetasin Zh.;
 - ✓ më datë 13.02.2012, në vlerën prej 30,000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi; dhe
 - ✓ më datë 02.11.2010, transfertë *cash* në vlerën 10,000 dollarë, me përfitues shtetasin kinez, z. Zh., me qëllim shlyerje detyrimi.
- iii. Subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues lidhjen dhe shkakun se përse ai duhet ta kryente këtë transfertë në favor të z. N.M apo biznesit të tij familjar duke mos provuar se:
 - ✓ ai ka qenë asistent pranë avokat N.M, më datë 01.09.2008, pranë zyrës së tij avokatore, pasi nuk paraqiti as dokumente që provonin se z. N.M., kishte qenë avokat dhe as vërtetim nga Dhoma e Avokatisë Tiranë se ai ishte regjistruar në regjistrin e asistentëve avokatë pranë Av. N.M, sipas ligjit “Për Avokatinë”;
 - ✓ ku janë njohur subjekti i rivlerësimit me z. N.M.
- iv. Subjekti i rivlerësimit pranon se i ka kryer këto transfertat në vitet 2010 - 2012 dhe në vite të tjera deri në janar të vitit 2015, ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumën e lejuar prej 3,5 milion lekësh, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor.

2. Për detyrimet tatimore ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë në shumën prej 242,518 lekësh dhe detyrimet ndaj Njësisë Administrative Kashar, në shumën prej 144.400 lekësh.

- i. Subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar detyrimin tatimor ndaj Njësisë Administrative Kashar, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, seksioni detyrime.
- ii. Pavarësisht faktit që ai i ka paguar detyrimet në momentin kur ju paraqitën rezultatet e hetimit, ai duhej të kishte pasur dijeni dhe të kishte paguar atë para deklaratës “Vetting” të vitit 2017. Pra deklarimi i detyrimit dhe/ose shlyerja e tij duhet të kishin ndodhur para se të deklaronte.

3. Në lidhje me etikën dhe integritetin

- i. Veprimet e subjektit, për transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregojnë një mungesë të theksuar të përbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, nga ku parashikohet se “...sjelljet e një magjistrati si gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij duhet të garantojnë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut te sistemi i drejtësisë...” Gjithashtu këto sjellje bien në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes sipas nenit 4 të ligji nr. 96/2016, i cili përcakton se “*Magjistrati merr të gjitha masat e*

arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtarinë e kryera edhe kur magjistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare”.

- ii. Trupi gjykues, çmon se është e vërtetë që legjislacioni tatimor, parashikon se në rast pagesë më vonesë aplikohen penaltete, por çmon se këto detyrime u paguan gjatë procesit dhe veprimet apo mosveprimet e tij janë sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elementë të cilët cenojnë figurën e magjistratit.
- iii. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e këshilltarit ligjor në kohën që janë transferuara shumat e konsiderueshme dhe të pajustifikuara, **Komisioni, çmon se për kandidatët për magjistratë që synojnë të jenë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë, është shumë e rëndësishme sjellja dhe integriteti i tyre para se të kenë qenë pjesë e sistemit.** Kjo për faktin se veprimet e kryera nga subjekti si nga mënyra dhe shkaku janë cilësi të karakterit të subjekti të cilat nuk mund të mësohen në asnjë institucion edukimi por janë cilësi individuale të personit.
- iv. Duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është kualifikuar për trajnimin 2-vjeçar pranë Shkollës së Magjistraturës, do të thotë se në përfundim të trajnimit teorik dhe atij praktik ai do të emërohet magjistrat. Për të përmbushur objektivin e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar një sistem gjyqësor të pavarur dhe për të rikthyer besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, kontrolli i vërtetësisë së deklarimeve dhe sjellja e përgjithshme e kandidateve për magjistratë merr një rëndësi të veçantë për shkak se kandidatët për magjistrat janë themelet e një sistemi të pavarur drejtësie, për të arritur objektivin e Kushtetutës dhe ligjit.
- v. Komisioni, pas konstatimeve mbi faktet dhe analizimit të provave, i vlerësoi veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, si sjellje që tregonin mungesë të etikës dhe integritetit të tij, elementë të cilët cenojnë figurën e magjistratit.

Në vlerësimin tërësor të çështjes, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon, nuk arrijnë nivel të besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Në këto kushte, Komisioni, bazuar në provat që disponon, vlerësimin e çështjes në tërësi si dhe bindjen e brendshme vendosi që subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në nenet 179/b, D, DH, E, Ç të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë të ligjit nr. 76/2016, datë 22.07.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar”, në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar nenit 58, bazuar në pikën 3 dhe 5

të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, me funksion ndihmës ligjor pranë Gjykatës së Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, më datë 02.11.2018.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Etleda ÇIFTJA
Kryesuese

Brunilda BEKTESHI
Anëtare

Roland ILIA
Relator
Kundër

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka

MENDIM PAKICE

Për arsye se nuk ndaj të njëjtin mendim me shumicën e trupit gjykues për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra për subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, paraqes argumentet për qëndrimin tim në pakicë, si vijon:

Si anëtar i trupit gjykues, pas analizimit të rezultateve të hetimit administrativ, provave të mbledhura nga ky hetim, si dhe shpjegimeve e provave të sjella nga subjekti i rivlerësimit, nuk pajtohem me arsyetimin dhe përfundimin e arritur nga ana e kolegëve të shumicës, për sa i përket vlerësimit tërësor të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli, për sa më poshtë:

I. Lidhur me transfertat e kryera nga ky subjekt pranë "ICB".

Sipas shumicës, referuar nenit D, pika 3 e aneksit të Kushtetutës "*Subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore...*" arsyetohet se, lidhur me transfertat e kryera nëpërmjet "ICB" (përgjatë viteve 2010 - 2012) subjekti i rivlerësimit, (1) nuk arriti të provojë bindshëm se shumata që ai ka transferuar në llogari të shtetasit kinez Zh. kanë burim tregtinë e mallrave ose që detyrimi dhe borxhi ndaj shtetasit Zh. ishte për blerje mallrash, pasi subjekti nuk paraqiti asnjë kontratë apo dokument tjetër që ta vërtetonte këtë; (2) nuk arriti të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të ardhurat e ligjshme nga ai vetë apo z. N.M., që janë përdorur për krijimin e shumave të transferuara, nuk paraqiti asnjë dokument shoqërues që të vërtetonte burimin e transfertave; (3) nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor provues lidhjen dhe shkakun se përse ai duhet ta kryente këtë transfertë në favor të z. M. apo biznesit të tij familjar; (4) deklaratimet e bëra nga, z. N.M., nuk u provuan me dokumentacion ligjor provues, me qëllim që të mbështesnin deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me shkakun e kryerjes së këtyre transfertave si dhe mundësitë financiare nga burime të ligjshme të këtyre shumave; (5) subjekti i rivlerësimit pranon se ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumë e lejuar prej 3,5 milion lekë, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor.

Nuk bie dakord me shumicën për konkluzionin e arritur në këtë rast, për sa më poshtë vijon:

Subjekti i rivlerësimit është emëruar, më datë 03.06.2015, në detyrën e ndihmësit ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë dhe se, bazuar në pikën 1 të nenit 31 të ligjit nr. 84/2016,⁷ është bërë subjekt deklarues për herë të parë pranë ILDKPKI-së, pasi për nga funksioni që ka pasur nuk ka qenë përfshirë në kategorinë e subjekteve që mbartnin detyrim për deklarimin pasurisë.

Referuar "Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting" të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit, më datë 29.01.2017, konstatohet se, ai ndër të tjera ka deklaruar edhe llogarinë bankare në Internacional Comercial Bank, me gjendje 0(zero) lekë.

⁷ Subjekti i rivlerësimit plotëson deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2, bashkëlidhur këtij ligji, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon pranë ILDKPKI-së.

International Commercial Bank, me shkresën nr. *** prot., datë 03.07.2018, na konfirmoi se subjekti i rivlerësimit rezulton të ketë pasur llogari rrjedhëse në monedhën dollar në periudhën 2010 - 2013. Nga historiku i kësaj llogarie vërehet se, janë kryer dy transfertë, përkatësisht më datën 14.12.2010, në vlerën 16,000 USD, me përfitues shtetasin kinez Zh., dhe në datën 13.02.2012, në vlerën prej 30,000 USD, me qëllim shlyerje detyrimi. Gjithashtu, rezulton të jetë kryer dhe një transfertë *cash* në vlerën 10,000 USD, më datë 02.11.2010, me përfitues shtetasin kinez Zh. me qëllim shlyerje detyrimi. Në datën e deklaramit, subjekti i rivlerësimit nuk rezulton të ketë balancë pranë kësaj banke dhe se ajo është llogari jo aktive.

Jam i mendimit se, është lapsus deklarimit i subjektit gjendja zero lekë, ndërkohë që subjekti ka pasur dijeni që ka pasur një llogari në dollarë (me gjendje zero) në këtë bankë dhe se ka dorëzuar në ILDKPKI dokumentin “*nxjerrje llogarie*”, ku pasqyrohet gjendja e kësaj llogarie në dollar.

Konstatohet se, konkluzionet e nxjerra nga ana e shumicës lidhur me këto transfertë bien ndesh me njëra tjetrën dhe kanë tendencën të rëndojnë pozitën e subjektit, pasi nga njëra anë pretendojnë se subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë bindshëm se shumata që ai ka transferuar në llogari të shtetasit kinez Zh. ishin bërë për qëllim tregtar për blerje mallrash për nevoja të shtetasit N.M. dhe nga ana tjetër arrijnë në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit pranon se ka transferuar jashtë vendit në çdo rast shumë e lejuar prej 3,5 milion lekë, duke e ditur që ky ishte një veprim i cili favorizonte biznesin e z. N.M., duke kryer evazion tatimor.

Referuar pikës 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, “*subjektet e rivlerësimit i nënshtrohen deklarimit dhe kontrollit të pasurive të tyre, me qëllim që të identifikohen ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre*”.

Në vijim në pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, parashikohet se, “*subjekti i rivlerësimit duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave. Pasuri të ligjshme për qëllime të këtij ligji, konsiderohen të ardhurat që janë deklaruar dhe për të cilat janë paguar detyrimet tatimore*”.

Ndërsa në pikën 1 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se, “*subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, së bashku me deklaratën e pasurisë, paraqesin të gjitha dokumentet që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë*”.

Nga verifikimi dhe hetimi i kryer rezulton se, subjekti i rivlerësimit nuk ka pasuri të deklaruara dhe as pasuri të fshehura të gjetura nga ana e këtij Komisioni, përveç shumës prej afro 20,000 lekësh të mbetur në llogarinë e pagës së tij, në momentin e deklarimit.

Gjithashtu, konstatohet se subjekti i rivlerësimit në rubrikën e të ardhurave, ka deklaruar vetëm të ardhurat e përfituara nga paga si ndihmës ligjor në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues ligjor⁸. Këto të ardhura janë konfirmuar edhe nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore⁹.

⁸ Shih vërtetimet e pagave të dorëzuara nga subjekti dhe të administruara në dosjen e ILDKPKI-së.

⁹ Shkresa nr. ***prot., datë 02.07.2018.

Nga ana e shumicës, nuk është vërtetuar përtej çdo dyshimi të arsyeshëm se shumata e këtyre transfertave kanë të bëjnë me të ardhura të cilat i takojnë subjektit të rivlerësimit dhe se këto transfertat janë kryer për qëllime të aktivitetit të tij. Shumica, nuk provoi se me kryerjen e këtyre transfertave subjekti të ketë kryer ndonjë veprim të kundërligjshëm.

Në analizë të dispozitave dhe fakteve të mësipërme vlerësoj se, përderisa subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur të tij apo nuk ka deklaruar të ardhura që të lidhen me këtë transfertat nuk ka se si të ketë detyrimin për të justifikuar burimin e ligjshëm të këtyre vlerave të transferuara, për më tepër kur ato janë kryer në një kohë kur nuk ka qenë subjekt rivlerësimi dhe nuk ka pasur asnjë funksion shtetëror. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit me dorëzimin e deklaratës “Vetting” ka dorëzuar dhe *statementin bankar* të “ICB”, ku janë të pasqyruara këto transfertat.

Për shtetasin N.M., person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit, shumica nuk ka provuar se gjendet në kushtet e parashikuara në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016 (*në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit dhe huamarrësit*), sipas të cilave ka detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

Në shpjegimet e tij, subjekti ka deklaruar se këto transfertat janë kryer për llogari të shtetasit N.M., për aktivitetin e tij tregtar. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe z. N.M., duke shtuar se këto transfertat janë bërë në mirëbesim dhe pa kundërshtim. Z. N.M., në dëshminë e tij paraqiti të dhëna të shumta, të cilat tregonin se në vazhdimësi ai dhe familjarët e tij kanë kryer aktivitet tregtar me Republikën Popullore të Kinës.

Lidhur me marrëdhënien ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. N.M. vlerësoj se, nuk ka dyshime se ato kanë pasur marrëdhënie shoqërore, pasi në vazhdimësi z. N.M. ka nënshkruar deklarata, ka kthyer përgjigje pranë këtij Komisioni, madje na ka dhënë dhe dëshmi që vërtetojnë se ndërmjet tij dhe subjektit të rivlerësimit ka pasur njohje të mëparshme dhe lidhje shoqërore. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit na ka paraqitur një vërtetim të lëshuar nga z. N.M., sipas së cilit ai ka filluar si asistent pranë zyrës së avokatisë së tij, më datë 01.09.2008. Nga ana jonë, me shkresën nr. *** prot., datë 08.10.2018, i kemi drejtuar Dhomës Kombëtare të Avokatisë, me qëllim konfirmimin e faktit nëse ka qenë asistent dhe nëse ka kryer praktikën pranë zyrës së avokatit N.M., por ende nuk na është kthyer përgjigje.

Gjithsesi çmoj se, marrëdhëniet shoqërore të subjektit të rivlerësimit dhe z. N.M. nuk vihen në dyshim dhe se fakti se nuk është provuar tej çdo dyshimi se subjekti i rivlerësimit ka qenë asistent i z. N.M. nuk përbën argument/provë thelbësore për vendimmarrjen.

Gjithashtu, shumica ka evidentuar mospërputhje midis deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe deklarimeve të dhëna nga shtetasi N.M., pasi në dëshminë e tij dhënë Komisionit, më datë 01.10.2018, z. N.M. deklaroi se, “*E ka njohur, z. Artor Ylli, që në vitet 2008 - 2009, pasi e ka pasur student të shkollës jo-publike “***” dhe më pas ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë, për efekt të provimit përfundimtar të avokatisë, meqenëse i duhej vërtetim si asistent avokat.*”, ndërsa nga deklarimi në formularin e kontrollit të figurës, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka mbaruar studimet në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë në Tiranë.

Lidhur me këtë fakt konstatoj se, në “procesverbalin mbi marrjen e deklarimeve” të zbardhur, më datë 01.10.2018, nuk është pasqyruar saktë dëshmia e dhënë nga z. N.M. lidhur me rrethanat e njohjes së tij me subjektin e rivlerësimit. Nga dëshmia e marrë, z. N.M., në prezencën time në cilësinë e relatorit të çështjes, edhe të vëzhguesit ndërkombëtar z. Theo Jacobs, nga dëshmitari u evidentua fakti se, *e ka njohur subjektin e rivlerësimit, pasi vëllain e tij e ka pasur student te shkolla jo- publike “***” dhe se më pas ka qenë asistent avokat pranë zyrës së tij të avokatisë.* Ndërsa nga dokumentacioni i administruar në dosje, provohet se subjekti ka mbaruar studimet dhe është diplomuar me titullin “jurist”, në Universitetin e Tiranës, Fakulteti i Drejtësisë.

Në përpjesimet e sjella pranë Komisionit subjekti ka shpjeguar se, është i pasaktë deklarimi i z. N.M., se subjekti e ka njohur gjatë kohës që ka qenë student në institucionin privat të arsimit të lartë “***”.

Sa më sipër, lidhur me transfertat bankare të kryera nga subjekti i rivlerësimit, nga analizimi në tërësi i fakteve dhe provave të administruara në dosje, konstatoj se:

- i. në kohën që subjekti ka kryer këto transfertat nuk ka qenë subjekt deklarues pranë ILDKPKI-së dhe se nuk ka pasur ndonjë funksion shtetëror;
- ii. me kryerjen e këtyre transfertave subjekti nuk ka kryer veprime të kundërligjshme/që bien ndesh me ligjin;
- iii. subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar pranë ILDKPKI-së nxjerrjen e llogarisë së tij në dollar pranë “ICB”-së, ku pasqyrohen edhe këto transfertat të kryera nga ai ndër vite, fakt ky që tregon se është bashkëpunues dhe transparent¹⁰, për qëllim të këtij procesi;
- iv. subjekti i rivlerësimit nuk ka pasuri të deklaruara dhe as pasuri të fshehura të gjetura nga ana e këtij Komisioni (përveç shumës prej afro 20,000 lekësh të mbetur në llogarinë e pagës së tij), për pasojë nuk mund të ketë dyshime se këto transfertat janë kryer në emër dhe për llogari të tij lidhur me ndonjë aktivitet tregtar apo aktivitet tjetër të mundshëm të kryer nga ai;
- v. nisur nga dëshmitë e marra dhe provat e administruara, këto transfertat janë kryer me kërkesën e z. N.M. dhe për qëllime të aktivitetit tregtar të familjarëve të tij. Sikurse ka dalë gjatë hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pasur lidhje miqësore me shtetasin N.M., pasi ka qenë asistent avokat i këtij të fundit;
- vi. nga analizimi i të dhënave dhe dëshmive të marra, qëllimi final i kryerjes së këtyre transfertave ka qenë shmangia e detyrimeve tatimore nga subjekti “***” person fizik. Gjithashtu çmoj se, *subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë përcaktues në mundësinë e kryerjes së evazionit fiskal nga tatimpaguesi i lartpërmendur*, kjo për faktin se:
 - a) legjislacioni shqiptar¹¹ parashikon parapagimin në doganë të tatimit mbi vlerën e shtuar për importet e kryera dhe si njëdhjetë subjektet importues, të cilët mendohet të jenë subjekte të ndryshëm nga subjekti “***” p.f., me zhdoganimin e këtyre mallrave kanë paguar paraprakisht përveçse detyrimeve doganore dhe tatimin mbi vlerën e shtuar;

¹⁰ nuk është mundur të fshehë transfertat e kryera nga kjo llogari, megjithëse nuk ka pasur detyrimin të dorëzonte statement bankar.

¹¹ neni 2, germa “b”, e ligjit nr. 7928, datë 27.04.1995, “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar” (ligji në fuqi në kohën e kryerjes së importeve).

- b) deklaratat e zhdoganimit të këtyre subjekteve¹² janë objekt i mundshëm kontrolli i administratës tatimore me qëllim identifikimin e blerjeve, çka do të thotë se në rast të kryerjes së një kontrolli tatimor, sasia e mallrave dhe lloji i tyre është lehtësisht i verifikueshëm dhe se rrjedhimisht mbas një bilanci material të mallrave gjendje, mund të evidentohet dhe sasia e mallrave/lloji i tyre të shitura dhe në përfundim të llogariten shitjet e kryera¹³, mbi të cilat subjekti duhet të paguajë TVSH dhe detyrimet e tjera tatimore.
- vii. nga teresia e akteve dhe provave të administruara në dosje, nuk konfirmohet dijenia e subjektit për qëllimin e fshehur¹⁴ të kryerjes së këtyre transfertave, por duket se ka vepruar në mirëbesim. Ky fakt, përforcohet edhe nga dëshmia e z. N.M., i cili ka deklaruar se këto transferta janë kryer për llogaritë të tij, në mirëbesim dhe pa kundërshtimet e blin.
- ❖ Nën këto argumente, duken bindëse shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit lidhur me qëllimin e kryerjes së këtyre transfertave.

II. Lidhur me detyrimet tatimore dhe taksat e papaguara

Me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar, (1) detyrim fiskal ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në shumën prej 242,518 lekësh dhe (2) detyrime ndaj Njesisë Administrative Kashar, në shumën prej 143,780 lekësh.

Lidhur me këto detyrime shumica ka arritur në konkluzionin se, (1) subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar detyrimin tatimor ndaj Njesisë Administrative Kashar, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017, seksioni detyrime dhe (2) pavarësisht faktit që ai i ka paguar detyrimet në momentin kur ju paraqitën rezultatet e hetimit, ai duhej të kishte pasur dijeni dhe ti kishte paguar ato para deklaratës “Vetting” të vitit 2017. Pra deklarimi i detyrimit dhe/ose shlyerja e tij duhet të kishin ndodhur para se të deklaronte. Shumica pretendon se, këto veprime dhe mosveprime të tij janë sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elementë që cenojnë figurën e magjistratit.

Nuk bie dakord me shumicën lidhur me konkluzionet e arritura për sa i përket detyrimeve tatimore të papaguara, për sa më poshtë vijon:

Vlerësoj se, nuk qëndron konkluzioni i shumicës se subjekti ka bërë deklaram të pamjaftueshëm pasi nuk ka deklaruar detyrimin tatimor ndaj Njesisë Administrative Kashar, në deklaratën “Vetting” të vitit 2017. Nga verifikimi i “Deklaratës së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”, të dorëzuar nga subjekti pranë ILDKPKI-së, më datë 29.01.2017, konstatohet se, në faqen 7 të saj në rubrikën “*Detyrime Financiare ndaj Personave Juridike dhe Fizike*” subjekti ka deklaruar detyrim fiskal ende të pashlyer ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, në shumën prej 242,618 lekësh, dhe ndaj Njesisë Administrative Kashar, në shumën prej 143,780 lekësh.

Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë¹⁵ konfirmon se, subjekti i rivlerësimit ka detyrime të papaguara në vlerën prej 193,061 lekësh, vlerë më e vogël nga detyrimet e deklaruara në

¹² Informacion lidhur me to i dërgohet edhe administratës tatimore.

¹³ Duke i llogaritur dhe normë fitimi.

¹⁴ Qëllimin që ka pasur urdhëruesi real i tyre.

¹⁵ Shkresa me nr. ***prot., datë 10.07.2018.

deklaratën “Vetting”, të cilat mendohet se janë ulur si pasojë e pagesave të bëra nga ana e subjektit dhe përfitimit nga ligji nr. 33/2017¹⁶ “Për pagesën dhe fshirjen/shuarjen e detyrimeve tatimore, detyrimeve të pagueshme në doganë, si dhe procedurën e heqjes nga qarkullimi të mjeteve të transportit pas fshirjes /shuarjes së detyrimeve tatimore”.

Njësia Administrative Kashar¹⁷ ka konfirmuar se, subjekti “Artor Ylli”, me NIPT ***, figuron debitori në vlerën prej 144,100 lekësl.

Vlerësoj se, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në rubrikën përkatëse detyrimet ndaj Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë dhe ndaj Njesisë Administrative Kashar, por se ndryshimi i vlerave të këtyre detyrimeve nga momenti i deklarimit me momentin e konfirmimit të tyre nga organet përkatëse, ka të bëjë me pagesa të kryera nga ana e subjektit, përfitim nga ligji i faljes së detyrimeve si edhe interesa të shtuara në rastin e detyrimeve ndaj Njesisë Administrative Kashar.

Sikurse është pasqyruar edhe në arsyetimin e shumicës, subjekti i rivlerësimit, më datë 26.10.2018, ka shlyer tërësisht detyrimin që kishte ndaj Njesisë Administrative Kashar. Ndërsa lidhur me detyrimin e mbetur ndaj DRT-së Tiranë subjekti ka sqaruar se, këtë detyrim do ta shlyej, por në momentin e deklarimit nuk ka mundësi financiare për ta shlyer.

Referuar pikës 1 të nenit 6 të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë”, *detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit tatimor.*

Ndërsa në pikën 3, të këtij neni, parashikohet se, *“detyrimi tatimor përfshin tatimin, kamatëvonesat, si dhe gjokat, për rastet e parashikuara nga ky ligj”.*

Në analizë të dispozitave të mësipërme vlerësoj se, detyrimet tatimore nga aktiviteti tregtar lidhen drejtpërdrejtë me realizimin e të ardhurave.

DRT-ja Tiranë¹⁸ na informon se, të ardhurat e realizuara sipas deklaratave vjetore të dorëzuara nga ana e subjektit tregtar “Artor Ylli”, me NIPT ***, për vitet 2010 – 2014, janë 0(zero) dhe se ky subjekt nuk ka deklaruar qarkullim dhe as fitim. Ndërsa, në përgjigjen e ardhur nga DRT-ja Tiranë¹⁹, të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, subjekti ka deklaruar me vlerë 0 lekë, FDP-të e TVSH-së, ka ndërprerë deklarimin në periudhën dhjetor 2012 dhe se rezulton me detyrime të paguara në vlerën prej 47,618 lekësh.

Nga verifikimi i përgjigjes së ardhur nga DRT-ja Tiranë, e konkretisht tabelës bashkëlidhur shkresës që pasqyron detyrimet në kohë reale (të datës 06.07.2018) konstatohet se, detyrimet e subjektit janë vetëm gjoka dhe kamata vonesa.

¹⁶ Sipas vetëdeklarimit të subjektit në prapësimet e sjella pranë Komisionit.

¹⁷ Me shkresën nr. *** prot., datë 24.09.2018.

¹⁸ Shkresa me nr. *** prot., datë 10.07.2018.

¹⁹ Aneks nr. 31 në dosjen e ILDKPKI-së.

Pra rezulton se, subjekti nuk ka "tatim" të papaguar ndaj DRT-ja Tiranë, por vetëm gjoba dhe interesa, për të cilat kanë ardhur si rrjedhojë e mosdorëzimit në kohë të deklaratave tatimore, qoftë edhe me vlerë 0(zero).

Në nenin 74, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", parashikohen afatet dhe mënyrat e pagesës së detyrimit tatimor. Referuar pikës 2, të këtij neni, "kur administrata tatimore nxjerr vlerësimin e një detyrimi tatimor, në përputhje me kreun VIII të këtij ligji, detyrimi tatimor i vlerësuar paguhet brenda 30 ditëve kalendarike, nga data në të cilën tatimpaguesi ka marrë ose vlerësohet të ketë marrë njoftimin e vlerësimit dhe kërkesen për pagesë".

Ndërsa në nenin 89, të këtij ligji "Njoftimi dhe kërkesa për tu paguar", në pikat 1 dhe 2 të tij, përcaktohet shprehimisht se:

"...1. Sa herë që administrata tatimore konstaton se një tatimpagues nuk ka paguar plotësisht dhe në datën e caktuar detyrimet tatimore, administrata tatimore i dërgon, me postë rekomande, një njoftim me shkrim, ku kërkon pagesën e plotë të detyrimit tatimor. Për njoftimin dhe kërkesën për të paguar zbatohen afatet dhe procedurat e parashikuara në nenin 69 të këtij ligji.

2. Nëse tatimpaguesi nuk përdor të drejtën e ankimit dhe nuk paguan detyrimin tatimor, administrata tatimore duhet ta mbledhë tatimin, duke përdorur njërën ose disa prej mënyrave, të parashikuara në këtë kre. "

Nga DRT-ja Tiranë, nuk na është përcjellë ndonjë akt që i është drejtuar tatimpaguesit që ka të bëjë me njoftim vlerësimin e detyrimit tatimor apo njoftimin për pagesën e detyrimit tatimor.

Duke qenë se, këto detyrime nuk janë detyrime të vetëdeklaruar nga subjekti, por janë penalitete të vendosura nga DRT-ja Tiranë vlerësoj se, subjekti duhet të merrte dijeni nëpërmjet një njoftimi zyrtar të DRT-së Tiranë. Shumica nuk ka provuar se subjektit i është dërguar njoftim vlerësimi apo njoftim kërkesë për tu paguar.

Njoftimi që duhet t'i dërgonte DRT-së Tiranë, përbën dhe aktin administrativ sipas të cilit subjekti kishte të drejtë të ankimonte këto detyrime, në rrugë administrative dhe më tej në rrugë gjyqësore.

Gjithashtu, konstatohet se ndaj subjektit "Artor Ylli", me NIPT ***, nga administrata tatimore nuk janë ndërmarrë masa për mbledhjen me forcë të detyrimit tatimor, të parashikuara në kreun XI, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Shumica ka synuar ta evidentojë si gjetje faktin se subjekti ka pasur dijeni për detyrimet tatimore dhe nuk i ka paguar ato, ndërkohë që subjekti i ka vetëdeklaruar këto detyrime, ka pranuar ekzistencën tyre dhe në qëndrimin e tij ka deklaruar se do ti paguaj plotësisht ato, praktikisht duke hequr dorë nga e drejta e ankimit që lidhet me lindjen e këtyre detyrimeve.

Në vlerësimin përfundimtar lidhur me këto detyrime, nga verifikimi i materialeve të administruar në dosje konstatohet se, subjekti nuk ka krijuar të ardhura nga aktiviteti i tij tregtar në fushën e avokatisë, të ardhurat e tij të deklaruara dhe të konfirmuara me dokumentacion provues janë të

pakta²⁰ dhe për ligjin shpjegimin e subjektit lidhur me mungesën e burimeve financiare për pagesën e plotë të këtyre detyrimeve.

Si rrjedhim çmoj se, mungesa e aftësisë paguese nga ana e subjektit nuk përbën shkelje të normave të etikës, të cilat mund të cenojnë figurën e subjektit.

III. Kontrolli i figurës dhe vlerësimi i aftësive profesionale

Lidhur me rivlerësimin e kriterit të figurës dhe të aftësive profesionale, mbaj të njëjtin qëndrim me vendimnartjen e shumicës së anëtarëve të trupit gjykues.

IV. Në lidhje me etikën dhe integritetin

Për sa i përket 2 çështjeve të trajtuara më sipër, transfertave të kryera nga ana e subjektit si edhe detyrimeve tatimore, shumica i ka trajtuar veçmas edhe si shkelje të etikës dhe mungesë integriteti nga ana e subjektit, duke vlerësuar se:

1. Veprimet e subjektit, për transfertat bankare në mënyrë të përsëritur, të pajustificuara me burime të ligjshme, tregojnë një mungesë të theksuar të përmbushjes së vlerave themelore që duhet të udhëheqin një magjistrat të ardhshëm, sipas nenit 3 të ligjit nr. 96/2016, nga ku parashikohet se *“...sjelljet e një magjistrit si gjatë ushtrimit të funksionit dhe jashtë tij duhet të garantojnë ruajtjen dhe forcimin e besimit të publikut të sistemi i drejtësisë...”* Gjithashtu këto sjellje bien në kundërshtim me standardet e etikës dhe rregullat e sjelljes sipas nenit 4 të ligji nr. 96/2016, i cili përcakton se *“Magjistrit merr të gjitha masat e arsyeshme për të ruajtur dinjitetin e funksionit, duke përfshirë veprimtarinë e kryera edhe kur magjistrit nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare”*.

2. Është e vërtetë që legjislacioni tatimor parashikon se në rast pagese me vonesë aplikohen penalitete, por këto detyrime u paguan gjatë procesit dhe veprimet apo mosveprimet e tij janë sjellje që tregojnë mungesë etike dhe integriteti, elementë të cilët cenojnë figurën e magjistratit.

3. Edhe pse subjekti i rivlerësimit nuk ka qenë në detyrën e këshilltarit ligjor në kohën që janë transferuar shumata e konsiderueshme dhe të pajustificuara, kandidatet për magjistratë që synojnë të jenë pjesë e sistemit të ri të drejtësisë, është shumë e rëndësishme sjellja dhe integriteti i tyre para se të kenë qenë pjesë e sistemit. Kjo, për faktin se veprimet e kryera nga subjekti si nga mënyra dhe shkaku janë cilësi e karakterit të subjektit, të cilat nuk mund të mësohen në asnjë institucion edukimi por janë cilësi individuale e personit.

4. Duke pasur parasysh se subjekti i rivlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” është kualifikuar për trajnimin 2 vjeçar pranë shkollës së magistraturës, do të thotë se në përfundim të trajnimit teorik dhe atij praktik ai do të emërohet magjistrat. Për të përmbushur objektivin e ligjit nr. 84/2016, për të garantuar një sistem

²⁰ Sipas vërtetimit, nr. *** prot., datë /01.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë (aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së).

gjyqësor të pavarur dhe për të rikthyer besimin e publikut tek sistemi i drejtësisë, kontrolli i vërtetësisë së deklaratimeve dhe sjellja e përgjithshme e kandidatëve për magistratë merr një rëndësi të veçantë për shkak se kandidatet për magistrat janë themelet e një sistemi të pavarur drejtësie, për të arritur objektivin e kushtetutës dhe ligjit.

5. Pas konstatimeve mbi faktet dhe analizimit të provave, i vlerësoi veprimet e kryera nga subjekti i rivlerësimit, si sjellje që tregon mungesë të etikës dhe integritetit të tij, elementë të cilët cenojnë figurën e magistratit.

Si anëtar i trupit gjykues, nuk ble dakord me shumicën lidhur me konkluzionet e arritura, për sa më poshtë vijon:

Së pari, referuar shkronjës “gj”, të nenit 2, të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe Prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, *magjistrat është gjyqtari, me përjashtim të gjyqtarit të Gjykatës Kushtetuese, prokurori dhe kryetari në kuptim të shkronjës “g” të këtij neni.*

Konkretisht në nenin 3 dhe nenin 4 të ligjit nr. 96/2016, përcaktohen vlerat themelore, të drejtat, detyrimet dhe standardet e sjelljes për magistratët, gjatë kohës të cilët ata janë në detyrë, përfshirë dhe veprimtaritë e kryera edhe kur magistrati nuk është duke ushtruar funksionet zyrtare. Ndërkohë që subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magistratit dhe nuk mund të jetë ligji nr. 96/2016 dhe dispozitat e tij, ligj i aplikueshëm për vlerësimin e etikës dhe integritetit të tij.

Së dyti, shumica me vlerësimin e saj, lidhur me mospagimin e detyrimeve tatimore nga ana e subjektit të rivlerësimit, shkel të drejtat dhe liritë themelore të tij, pasi referuar pikës 2, të nenit 18, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, *askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare e filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.*

Më sipër, nga ana ime është arsyetuar gjerësisht dhe janë dhëna argumente të cilat kundërshtojnë qëndrimin e shumicës lidhur me transfertat e kryera edhe detyrimet e papaguara nga ana e subjektit.

Së treti, shumica ka mbajtur një qëndrim paragjykes për subjektin, me arsyetimin që ajo bën në lidhje me cilësinë e tij si kandidat për magistrat.

Z. Artor Ylli, është subjekt i rivlerësimit që i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 4, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nisur nga funksioni që ka pasur si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Praktikisht, ky subjekt i është nënshtruar procesit të rivlerësimit për shkak të funksionit që ka pasur si ndihmës ligjor pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë, pasi legjislatori nuk ka parashikuar që kandidatet për magistratë duhet ti nënshtrohen procesit të rivlerësimit.

Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë, me shkresën nr. *** prot., datë 03.07.2018, na konfirmon se për ndihmësin ligjor, z. Artor Ylli, *nuk ka pasur dhe nuk ka procedim disiplinor.*

Dhoma Kombëtare e Avokatisë, nëpërmjet vërtetimit²¹ me nr. *** prot., datë 05.12.2014, ndër të tjera konfirmon se, ndaj Av. Artor Ylli, me licencë nr. 4162, *nuk është marrë asnjë masë disiplinore.*

Vërej se, shumica nuk i ka marrë në konsideratë këto prova, të cilat tregojnë të dhëna për etikën dhe integritetin në punë të subjektit të rivlerësimit dhe konkretisht për punë që lidhen drejtpërdrejtë me sistemin e drejtësisë.

Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit, në mbështetje të pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në cilësinë e ndihmësit ligjor pranë Gjykatave Administrative ka marrë pjesë në testimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës dhe se, në mbështetje të nenit 165 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, bën pjesë në subjektet të cilët kanë marrë të paktën 60 % të pikëve në testimin e aftësive profesionale dhe se ka të drejtë të ndjekë programin 2-vjeçar të trajnimit teorik dhe të praktikës profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

Vlerësoj se, qëllimi parësor i testimit të bërë nga Shkolla e Magjistraturës është vlerësimi i aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit sipas parashikimeve të ligjit nr. 84/2016, në këtë rast të ndihmësit ligjor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

Lidhur me nenin 165, të ligjit nr. 96/2016, konstatohet se, ky nen është një dispozitë kalimtare që parashikon të drejtën që gëzojnë, këshilltarët ligjorë pranë Gjykatës Kushtetuese dhe Gjykatës së Lartë, ndihmësat ligjorë pranë Prokurorisë së Përgjithshme dhe Gjykatës Administrative si edhe inspektorët në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, të cilët nuk kanë statusin e magjistratit, për të ndjekur programin 2-vjeçar nëse kanë arritur të paktën 60 për qind të pikëve të testit të aftësive profesionale në Shkollën e Magjistraturës.

Theksoj se, kjo është një e drejtë e këtyre subjekteve dhe jo detyrim, çka do të thotë që mund të zgjedhin të mos e nënshkruajnë marrëveshjen e regjistrimit me Shkollën e Magjistraturës, duke hequr dorë nga e drejta për të ndjekur programin dy-vjeçar të trajnimit.

Subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, bazuar në informacionin e dërguar nga Shkolla e Magjistraturës²² ka nënshkruar marrëveshjen me këtë shkollë për të ndjekur programin 2-vjeçar të trajnimit.

Së katërti, shumica ka vlerësuar se subjekti ka kryer deklaratime të pasakta e të pamjaftueshme. Lidhur me këtë konstatim vlerësoj se, në asnjë rast subjekti nuk ka kryer deklaratime të pasakta, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar të dorëzuar pranë ILDKPKI-së, në deklaratën për kontrollin e figurës së dorëzuar pranë DSIK-së, deklaratën që lidhet me aftësitë profesionale të dorëzuar pranë KLD-së, apo në deklaratimet e dhëna pranë Komisionit. Subjekti ka qenë bashkëpunues gjatë gjithë procesit.

²¹ Aneks 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së, dokument i dorëzuar nga subjekti.

²² Shkresa nr. *** prot., datë 16.10.2018.

Së fundmi, nga analizimi dhe vlerësimi në tërësi i fakteve dhe provave vlerësoj se, veprimet e kryera nga subjekti nuk tregojnë mungesë të etikës dhe integritetit të tij, të cilat mund të cenojnë figurën e tij.

V. Vlerësimi tërësor

Në vlerësimin tërësor të çështjes shumica ka vlerësuar se, mbështetur në provat, faktet dhe rrethanat që Komisioni disponon, nuk arrijnë nivel të besueshëm për subjektin e rivlerësimit, duke cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.

Si anëtar i trupit gjykues nuk pajtohem me mendimin e shumicës, pasi çmoj se bazuar në provat, faktet dhe rrethanat e dala gjatë hetimit administrativ të kryer, nuk u provua që subjekti i rivlerësimit të ketë kryer veprime të kundërligjshme apo veprime që kanë cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë, marrë në konsideratë këtu që, veprimet për të cilat shumica ka disponuar për shkarkimin e tij, janë kryer në një kohë që subjekti nuk ka qenë pjesë e sistemit të drejtësisë.

Sa më sipër, nga rrethanat e faktit dhe të dhënat që kanë mundur të administrohen nga hetimi administrativ, por edhe nga shpjegimet e provat e sjella nga subjekti i rivlerësimit, shpreh bindjen e bazuar në prova dhe ligj se subjekti i rivlerësimit, z. Artor Ylli, nuk ndodhet në asnjë nga rastet e parashikuara nga neni 61, të ligjit nr. 84/2016, titulluar “*Shkarkimi nga detyra*”.

Niveli i konstatimeve në lidhje me pasuritë, vlerësimin e figurës dhe vlerësimin profesional, marrë në tërësinë e tyre, duke marrë në konsideratë dhe qëndrimin e subjektit të rivlerësimit, nuk plotësojnë kriteret dhe shkaqet që përlligjin marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Artor Ylli.

Në përfundim të gjithë arsyetimit të mësipërm, kam votuar kundër vendimit të marrë nga shumica e trupit gjykues për të shkarkuar subjektin e rivlerësimit, z. Artor Ylli, duke shprehur mendimin tim se subjekti duhet të konfirmohet në detyrë.

Për të gjitha argumentet e mësipërm vlerësoj se duhet të gjente zbatim neni 59/1 të ligjit nr. 84/2016 dhe shumica nuk duhet të kishte disponuar shkarkimin nga detyra të këtij subjekti, por konfirmimin e tij në detyrë.

Relator

Roland ILIA